



Radio Televizioni i Kosovës

Për Bordin e Drejtorëve :

RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2005

Prishtinë, 2006

PËRMBAJTJA

HYRJE

FJALA E KRYETARES SË BORDIT

FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

MISIONI

STAFI I RTK-SË

STRUKTURA ORGANIZATIVE

TELEVIZIONI

PROGRAMI INFORMATIV

Reforma e Dhomës së Lajmeve

Debatet

Edicioni i Lajmeve “Nëpër Kosovë”

PROGRAMI NË GJUHËT E KOMUNITETEVE ETNIKE

STRUKTURA GJUHËSORE E PROGRAMIT TË TELEVISIONIT TË KOSOVËS

PROGRAMI KULTUROR, DOKUMENTAR, ARSIMOR DHE PËR FËMIJË

PROGRAMI ARGËTUES DHE MUZIKOR

Emisionet e Reja

Koncertet dhe evenimentet

PROGRAMI SPORTIV

PROGRAMI I MËNGJESIT

OPERACIONET TEKNIKE

RADIO KOSOVA DHE RADIO BLUE SKY

PËRMBLEDHJE

RADIO KOSOVA

PROGRAMI INFORMATIV

PROGRAMET E TJERA

PROGRAMI NË GJUHËT E KOMUNITETEVE NË RK E BS

RADIO BLUE SKY

PROGRAMI INFORMATIV

PROGRAMET E TJERA

OPERACIONET TEKNIKE TË RADIOS

UEB-FAQJA e RTK-së

ADMINISTRATA

PROKURIMI

FINANCAT

Hyrje

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është shërbimi publik transmetues që ofron shërbimet e veta në fushën e transmetimit radioteleviziv dhe veprimtari të tjera, sipas definimit nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/13.

RTK-ja fillimisht u themelua përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit midis EBU-së (Unioni Evropian i Transmetimeve) dhe OSBE-së (Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) në vitin 1999. RTK-ja u licencua sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 mbi licencimin e mediave transmetuese, kurse si subjekt legal formalisht u themelua sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/13 mbi themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës si transmetues publik. RT_k-ja përbëhet nga dy njësi: Bordi i Drejtorëve dhe Operacionet Transmetuese.

Bordi i RTK-së i cili përbëhet nga nëntë anëtarë prej të cilëve tre janë ndërkombëtarë dhe gjashtë vendorë përfaqëson një spektër të gjerë të shoqërisë civile dhe multietnike.

RTK-ja përbëhet vetëm nga kanali terrestrial, një pjesë e të cilit emetohet edhe përmes transmetimit satelitor dhe nga dy radio stacione: Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, si dhe ka ueb faqen e vet në pesë gjuhë.

RTKja prodhon dhe transmeton program në pesë gjuhë: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome.

Radiotelevizioni i Kosovës është transmetuesi më i ri i shërbimit publik në Evropë. Në sajë të mbështetjes së institucioneve ndërkombëtare, atyre të Kosovës dhe punës së stafit të vet, kosovarët kanë radiotelevizionin e tyre të pavarur publik.

Si shërbim publik transmetues, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është pjesë e demokratizimit dhe një nga institucionet e rëndësishme të Kosovës. Si i tillë, RTK ndihmon në shprehjen e pluralizmit politik dhe diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe religjioz, si dhe në promovimin e mëtejme të produksionit vendor dhe integrimin shoqëror përgjithësisht.

Skema programore e RTK-së paraqet një balancim të programit të popullarizuar që i dedikohet një auditori të gjerë si dhe përmes shumë emisioneve të specializuara dedikuar bashkësive të veçanta. RTK-ja si shërbim publik përpiqet të ofrojë program për të gjithë qytetarët.

RTK-ja sot paraqet mozaikun shoqëror dhe etnik të Kosovës dhe i kontribuon rritjes ekonomike, inkurajon pluralizmin politik, avancoon diversitetin kulturor, dialogun, tolerancën ndëretnike, demokratizimin dhe integrimin shoqëror në përgjithësi.

Edhe gjatë vitit 2005, RTK-ja ka bërë hapa të rëndësishëm, si në aspektin programor dhe zhvillimor, duke ruajtur prestigjin, shikueshmërinë dhe besueshmërinë e Televizionit dhe dëgjueshmërinë e besueshmërinë e Radiove. Synimet kryesore të RTK-së për vitin 2005 janë arritur, si ruajtja e pavarësisë editoriale të RTK-së, arritjet në planin e zhvillimit cilësor të programit me përmbajtje tipike për një transmetues publik, të natyrës informative, edukative dhe argëtuese si dhe në avansimin e karakterit të vet multietnik.

Radiotelevizioni i Kosovës edhe gjatë vitit 2005 ka rikonfirmuar rolin e vet të pazëvendësueshëm të transmetuesit të pavarur publik të Kosovës, të respektuar në Kosovë dhe në rajon, si dhe pozicionin e vet kyç në informimin e opinionit kosovar si mediumi më i fuqishëm dhe më me ndikim i Kosovës.

Fjala e Kryetares së Bordit

Raporti vjetor për vitin 2005 do të vonohet për shkak të vonesës së raportit të auditivit të bërë nga Deloitte Kosova sh.p.k. Politika e Bordit të Drejtorëve të RTK-së duhet të ketë auditim të pavarur financiar para miratimit të raportit vjetor, kështu që ky raport është duke u kryer me një vonesë prej njëmbëdhjetë muajsh.

Raporti i këtij viti përfshin fillimin e reformës së përgjithshme ligjore dhe organizative të RTK-së si dhe avancimin e vetëqëndrueshmërisë financiare. Në vitin e gjashtë të ekzistencës dhe vitin e dytë të grumbullimit të parapagimit të transmetuesit publik, të hyrat janë duke u stabilizuar dhe me të ardhurat shtesë nga marketingu, kjo ka bërë të mundur funksionimin bazë të një kanali televiziv, të dy radio stacioneve dhe të uebsaitit, për të funksionuar me subvencion minimal nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Megjithëkëtë, RTK-ja mbetet mediumi publik me buxhetin më të vogël në Evropë.

Përkundër këtyre zhvillimeve, puna e RTK-së gjatë vitit 2005 ka qenë e suksesshme në implementimin e reformimit të dhomës së lajmeve që pasoi pas reitingut të audiencës të emisioneve të lajmeve, që arritën nivele të reja.

Sfidat politike dhe shoqërore të Kosovës u mbuluan në mënyrë profesionale dhe dinjitoze, ndaj edhe kritikët më të ashpër e pranuan profesionalizmin e lartë të stafit të ri të RTK-së. Politika e RTK-së për t'i shërbyer audiencës dhe paguesve të parapagimit me informacion dhe lajme korrekte dhe të paanshme ka rezultuar me një besim të audiencës në RTK-në, më shumë nga çdo burim tjetër informacioni.

Natyrisht, legjitimiteti i parapagimit është ruajtur dhe duhet të ruhet edhe me program të shkëlqyer, zbatim të ligjit dhe besueshmërisë. Hulumtimet e pavarura që konfirmojnë reitingun e lartë tek audiencia ka qenë indikator kyç i suksesit tonë. Reitingu për RTK-në ka dëshmuar se programi ynë dhe besimi i audiencës kanë qenë të parat në reitingun për vitin 2005. Në të gjitha sondazhet, TV-ja del e para, kurse Radio Kosova është e dyta pas një radio stacioni privat. Ky Bord i Drejtorëve aspiron të shohë RTK-në duke u zhvilluar si një transmetues publik shembullor në rajon.

Me zgjerimin e programit në gjuhët e minoriteteve, RTK-ja jo vetëm që ka plotësuar obligimin ligjor, por ka përmirësuar programin, si dhe pranueshmërinë e programeve minoritare nga shumica e komuniteteve gjuhësore në Kosovë.

Një nga objektivat tona për këtë vit ka qenë zgjidhja e çështjes së hapësirës punuese dhe të qëndrueshmërisë së ndërtesave. Për fat të keq, nuk kemi arritur këtë objektive, në rend të parë për shkak të mungesës së vullnetit politik të IPVQ-së dhe AKM-së. Megjithëkëtë, na mban shpresa se ky kusht fundamental për punën e RTK-së do të zgjidhet në të ardhmen e afërt.

Dr. Vjosa Dobruna
Kryetare e Bordit të Drejtorëve të RTK-së

Fjala e hyrjes e Drejtorit të Përgjithshëm

Viti 2005 shënon një hap të rëndësishëm drejt krijimit të vetëqëndrueshmërisë financiare të kompanisë sonë. Ky ishte vetëm viti i dytë i inkasimit të parapagimit publik dhe ne ia dolëm që edhe më tutje ta ulim shkallën e involvimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në buxhetin e përgjithshëm të RTK-së duke e reduktuar këtë vit në 8%.

Ne presim që nga 1 Janari 2006 të dalim krejtësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe kështu të financohemi në tërësi nga parapagimi publik si dhe nga të ardhurat tona vetanake. Duke qenë tani e tutje tërësisht të varur financiarisht drejtpërdrejtë nga qytetarët e Kosovës, ne kemi bërë një depërtim qenësor drejt transformimit të RTK-së në një shërbim të mirëfilltë, të përgjegjshëm dhe të pavarur transmetues publik evropian.

Gjatë këtij viti u zhvillua një diskutim i gjallë, ndonëse i pamjaftueshëm, lidhur me draftin e Ligjit për RTK-në. Ne përkrahim fuqimisht angazhimin e institucioneve vendore si dhe të atyre ndërkombëtare për ndërtimin e një legjislacioni të mirëfilltë medial në frymën e praktikave më të mira evropiane. Ne vlerësojmë se drafti i këtij ligji të rëndësishëm për shoqërinë kosovare në një masë të konsiderueshme reflekton një orientim të këtyllë. Mirëpo, ne gjithashtu kemi shfaqur rezerva dhe vërejtjet tona serioze ndaj disa pjesëve të këtij draft-ligji për të cilat konsiderojmë se objektivisht krijojnë hapësirë për ndërhyrje të cilat mund të çojnë drejt vendosjes së një lloji kontrolli politik dhe drejt etatizimit të RTK-së. Ne mbesim edhe më tutje me shpresë se amandamentet tona në Ligjin për RTK-në do të merren parasysh me rastin e miratimit të tij final që pritet të ndodhë në vitin 2006.

Viti 2005 veçohet edhe për nga përpjekjet e organizuara dhe intensive për reformën e shërbimit të lajmeve të RTK-së dhe avancimin e standardeve profesionale dhe etike të të gjitha segmenteve programore të kompanisë. Gjatë këtij viti është shënuar një hap i rëndësishëm në zbatimin e politikave të planifikuara dhe të funksionalizuara në fushën e trajnimit të stafit, sidomos atij gazetaresk. Pjekuria, siguria dhe paanshmëria me të cilat RTK-ja ka raportuar për sfidat me të cilat u ballafaqua Kosova gjatë këtij viti, dëshmojnë për profesionalitetin në rritje, përkushtimin dhe guximin e tërë stafit tonë që në shumicë përbëhet nga të rinjtë.

Në këtë vit me përkrahjen e OSBE-së filloi edhe një punë e gjatë, komplekse dhe voluminoze për reformimin e përgjithshëm ligjor dhe organizativ të RTK-së, të mbështetur në përvojat më të mira dhe standardet e Unionit Evropian të Transmetuesve (EBU).

Gjatë vitit 2005 është arritur një përparim i dukshëm cilësor dhe sasior në zhvillimin e programeve në gjuhët e të gjitha komuniteteve etnike të Kosovës. Magazinat javore dhe edicionet e rregullta të lajmeve në gjuhët e komuniteteve por edhe një varg emisionesh të tjera kanë shënuar një ngritje të cilësisë dhe kanë begatuar programin e përgjithshëm të

RTK-së.

Ne mbetemi të përkushtuar që në emisionet tona të veçanta por edhe me frymën e programit në tërësi, të vazhdojmë ta inkurajojmë dhe ta promovojmë dialogun dhe tolerancën, si rrugë të vetme të pranueshme për relaksim dhe zgjidhjen e konflikteve ndëretnike dhe të konflikteve tjera shoqërore në përgjithësi.

Me lansimin e edicionit të lajmeve për njerëzit me të meta në të dëgjuar, projekt ky i cili u realizua me përkrahjen e OSBE-së, u shënuar edhe një hap konkret drejt përmbushjes së rolit të RTK-së si shërbim publik transmetues për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Me bashkë-organizimin e EBU-së, OSBE-së dhe RTK-së në Dhjetor të vitit 2005 u mbajt në Vjenë Konferenca ndërkombëtare e donatorëve. Me këtë rast RTK-ja bëri prezantimin e disa projekteve të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit publik transmetues të Kosovës. Mbetemi me shpresë në efektet konkrete të kësaj konference sepse RTK-ja ka akoma nevojë për përkrahje ndërkombëtare sidomos në planin e zhvillimit të saj tekniko-teknologjik.

Angazhimi dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2005 na japin të drejtë që me vetëbesim të shtuar të përballemi me shumë detyra delikate dhe sfida që padyshim na presin në një të ardhme të afërt, e cila me siguri nuk do të jetë aspak monotone.

Agim Zatriqi

Prishtinë, Janar 2006

Misioni

Misioni i RTK-së është që t'i ofrojë auditorit informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues dhe të inkurajojë zhvillim harmonik të demokracisë dhe tolerancës.

Në zbatimin e misionit të vet RTK-ja ndjek këto parime dhe vlera:

Lirinë e fjalës dhe kreativitetin

Informimin e plotë

Pavarësinë

Objektivitetin

Korrektësinë

Saktësinë

Sinqeritetin

Respektimin e interesave dhe vlerave të shoqërisë

Respektimin e dinjitetit njerëzor, të drejtave individuale, të jetës private

Përgjegjësinë personale

Tolerancën

Opinionet e ndryshme


Me shfrytëzimin efektiv të fondeve të veta, RTK-ja mëton të prodhojë program cilësor argëtues dhe arsimor dhe lajme objektive, duke iu shmangur propagimit të dhunës, gjuhës së urrejtjes, violencës dhe shkeljes së normave etike.

Besueshmëria



Shikueshmëria

Burimi: Index Kosova



Stafi i RTK-së

Në fund të vitit 2005, RTK-ja ka pasur 425 të punësuar të rregullt. 307 meshkuj dhe 118 femra

Mosha moshatare e tyre është 40-vjeç. Më shumë se gjysma e të punësuarve të RTK-së kanë diploma universiteti.

Stafi	297	311	343	425
Viti	2002	2003	2004	2005

Me Planin e Biznesit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, ka qenë e paraparë që deri në fund të vitit 2005, gjithsejt të punësuar në RTK me kontrata të rregullta pune të jenë 442 punëtorë. Ndërkaq, në fund të vitit 2005, në RTK kanë qenë gjithsejt të punësuar 428 punëtorë.

Struktura Organizative

Bordi i Drejtorëve i RTK-së :

Kryetare
Vjosa Dobruna

Nënkryetar
Blerim Reka

Anëtarë
Milazim Krasniqi
Nuhi Rexhepi
Snezana Karadzic
Muhamet Mustafa
Boris Bergant
Uros Lipuscek dhe
Friedhelm Frischenschlager

Menaxhmenti i RTK-së:

Drejtori i Përgjithshëm
Agim Zatriqi

Drejtor i Televizionit
Liridon Cahani

Drejtor i Radios
Avni Spahiu

Drejtoreshë e Resurseve Njerëzore dhe Punëve Ligjore
Elvana Prekazi

Drejtor i Operacioneve Teknike
Ergyn Dobërçani

Drejtor i Financave
Bujar Spahiu

Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Trajnimet
Ilire Zajmi

Televizioni

Megjithë proceset dinamike dhe situatën delikate politike në Kosovë (zgjedhja e qeverisë së re, arrestimi i Kryeministrit, tentimi për vrasje i presidentit të Kosovës, kërcënimi me bombë brenda objektit të RTK-së, etj.), Televizioni i Kosovës i ka përmbushur obligimet e veta për të raportuar në mënyrën më profesionale të mundshme.

Në këtë kontekst, si një prej përpjekjeve më të rëndësishme strukturore për të përforcuar vlerat profesionale, ne e konsiderojmë përpilimin e dokumentit “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në RTK”, të aprovuar nga Bordi i RTK-së në fund të Janarit. Ky dokument është një doracak preciz i parimeve bazë të gazetarisë dhe etikës, mbështetur në dokumente të ngjashme të përpiluara nga transmetuesit më të respektuar publik evropian.

RTK-ja është bërë institucioni i parë medial në Kosovë i cili ka përvetësuar thelbësisht praktikën evropiane për vet-rregullimin e mediave elektronike. Në anën tjetër, hartimi dhe realizimi i një plani të gjerë për trajnim të stafit, kryesisht atij gazetaresk dhe editorial, ka ndikuar dukshëm në ngritjen e përgjithshme të cilësisë së punës.

Edhe më tutje po punohet në ngritje të nivelit të organizimit dhe planifikimit më të mirë të punës, sidomos në dhomën e Lajmeve.

Programi Informativ

Reforma gjithëpërfshirëse e dhomës së lajmeve, intensifikimi dhe ngritja e cilësisë së debateve lidhur me të gjitha çështjet vitale për funksionalizimin e shoqërisë kosovare përfshi këtu edhe nxitjen e dialogut ndërtnik kanë qenë objektivat themelore të programit informativ të Televizionit të Kosovës për vitin 2005.

Në këtë kontekst rezultatet e arritura janë të shumta dhe atë në të gjitha segmentet e lartpërmendura;

Reforma e dhomës së lajmeve

Pas pothuajse 6 muajsh përgatitjesh intensive Televizioni i Kosovës, në tetor, me sukses të plotë ka startuar me një edicion tërësisht të reformuar të Lajmeve qendrore, si dhe me dy edicione të reja të lajmeve në orën 15:00 dhe në mesnatë. Reforma e Lajmeve nënkupton një koncept plotësisht të ri strukturor, përmbajtësor dhe vizuel të Lajmeve. Reagimi i audiencës ka qenë pozitiv dhe vlerësojmë se kjo detyrë e komplikuar është realizuar me sukses.

Poashtu, në kuadër të reformës së përgjithshme organizative të RTK-së, hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë dhe ende po ndërmiren në reformën, organizimin dhe planifikimin më të mirë të punës brenda dhomës së Lajmeve. Trajnimet e organizuara me gazetarët dhe redaktorët e Dhomës së Lajmeve, në këtë kontekst kanë dhënë rezultate shumë të mira.

Është me rëndësi të përmendet edhe angazhimi i korrespondentëve të RTK-së nga Beogradi (shqiptar dhe serb) dhe Washingtoni.

Ndërkaq në vazhdim e sipër janë punët rreth specializimit të gazetarëve në fusha të caktuara të gazetarisë dhe sistematizimi i tyre nëpër redaksi dhe sektore brenda Dhomës së Lajmeve, me çka edhe do të përfundojë reforma e tërësishme e dhomës së Lajmeve. Niveli i përgjithshëm i raportimit, megjithë rrethanat shumë të komplikua politike e sociale ka qenë mjaft i lartë dhe ajo që është e rëndësishme, nuk janë shënuar shkelje të normave dhe parimeve profesionale. Dëshmia më e mirë për këto konstatime është niveli edhe më tutje shumë i lartë i besueshmërisë dhe shikueshmërisë që gëzojnë Lajmet e Televizionit të Kosovës te audienca.

Debatet

Një depërtim i theksuar, i Programit Informativ të Televizionit të Kosovës, është arritur në emisionet debatuese. Në këtë kontekst duhet gjithësesi përmendur ciklin e debateve Ndëretnike (më gjërësisht për këtë te Programet e komuniteteve etnike), ciklin “Jeta në Kosovë”, pastaj ciklin e debateve lidhur me çështjet pronësore i organizuar në bashkëpunim me OSBE-në, cikli i debateve për mbrojtjen e ambientit, etj. Më tutje kemi realizuar shume debate qe kanë të bëjnë me çështjet e integriteteve evropiane, ndërkaq një depërtim i rëndësishëm është bërë edhe në debatet politike sidomos në pjesën e dytë të vitit, pas angazhimit të kryeredaktorit të Programit Informativ.

Gjithësesi duhet përmendur edhe transmetimet e drejtpërdrejta të punimeve të Kuvendit të Kosovës, mbledhjeve të rregullta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe të ngjarjeve të tjera të rëndësishme. Poashtu rregullisht janë transmetuar edhe seancat e tribunalit të Hagës.

Edhe gjatë vitit 2005, RTK-ja me korrektësi ka mbuluar çofë me transmetime të drejtpërdrejta, çoftë me emisione speciale si dhe në të gjitha edicionet e lajmeve, shënimin e të gjitha festave fetare në Kosovë.

Edicioni i ri i Lajmeve “Nëpër Kosovë”

Ky edicion informativ nisi ashtu siç ishte planifikuar në gjysmën e dytë të Prillit, më 25/04/05 dhe planifikohet të jetë afatgjatë.

Menaxhmenti i RTK-së vendosi që ta lansojë për të integruar të gjitha gjuhët e komuniteteve në një bllok informativ në të cilin përqëndrimi kryesor janë problemet e qytetarëve nga të gjitha anët e Kosovës.

Edhe sigla është realizuar me sipërshkrime në të gjitha gjuhët e folura në Kosovë.

Kjo është një dëshmi simbolike por edhe e dukshme e tendencës së RTK-së për të kontribuar drejt integritetit ndëretnik.

Lajmet tona qëndrore janë të dominuara nga ngjarjet politike që zhvillohen kryesisht në Prishtinë. Pavarësisht prej kësaj është obligim i transmetuesit publik për ta informuar publikun edhe për ngjarje jo politike dhe proceset në tërë shoqërinë dhe në të gjithë territorin e Kosovës.


“Nëpër Kosovë” është programi i parë i llojit në Kosovë, i cili ngërthen në vete të pesë gjuhët e folura në Kosovë.

Kronikat transmetohen në origjinal me titrim në shqip. Veçori tjetër në realizimin e këtij edicioni është edhe kooperimi me televizionet lokale rreth prodhimit.

Reagimet e para të publikut kanë qenë pozitive posaçërisht nga ana e komuniteteve jashtë kryeqendrës.

Përvojat e transmetuesve të tjerë publik evropian dëshmojnë se edicionet gjeografikisht gjithpërfshirëse, janë segmente informative me ndikim, të popullarizuara te publiku dhe mënyrë efektive, në rastin tone, edhe mënyrë për të ngritur shikueshmërinë e lajmeve qendrore.

Paraqitja grafike e programeve të Televizionit të Kosovës e shprehur në përqindje:



Programi në gjuhët e komuniteteve

Përkushtimin e vet për të promovuar dialogun në mes të komuniteteve RTK-ja e ka realizuar në disa mënyra:

Dialogu për të ardhmen: Hap i rëndësishëm drejt integritit të shoqërisë kosovare është bërë me emetimin e një cikli 6 pjesësh të debateve, të titulluar “Dialogu për të ardhmen”.

Ky cikël është realizuar në periudhën Prill-Qershor të vitit të kaluar, me kohëzgjatje prej 60-90 minutash.

Në debate janë ftuar pjesëmarrës shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, romë dhe ashkalinjë, të cilët përfaqësojnë jetën politike e shoqërore në Kosovë, me të cilët janë trajtuar tema të ndryshme në interes të të gjithë kosovarëve. Debatet kanë pasur formatin e diskutimeve publike, me publikun prezent në studio, të cilit i jipej mundësia që në 15-20 minutat e fundit t’i parashtronjë pyetje pjesëmarrësve, ngjashëm me formatin e diskutimeve publike.

Edhe në publik janë përfshirë të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë.

Cikli udhëhiqej nga 2 moderatorë, njëri shqiptar dhe tjetri përfaqësues i komunitetit

gjegjës etnik.

Për përkrahje teknike (studio dhe pajisje për përkthim simultan në gjuhët gjegjëse) dhe për transportin e pjesëmarrësve dhe publikut jo shqiptarë të debateve, shumica e të cilëve jetojnë jashtë Prishtinës, iu drejtuam Departamentit për Demokratizim në kuadër të OSBE-së, i cili tregoi gatishmëri të plotë për ta përkrahur projektin.

Zëri i Amerikës (VOA) në gjuhën serbe: Në Korrik 2005 RTK-ja poashtu ka filluar me ritransmetimin e rregullt të edicionit të Zërit të Amerikës në gjuhën serbe.

Krahas kësaj edicioni i lajmeve të Televizionit të Kosovës në gjuhën serbe është bartur në kohë më të shikuar (në ora 19:00) para edicionit të lajmeve qëndrore si dhe është shtuar në skemë edhe transmetimin televiziv të një edicioni të lajmeve në gjuhën serbe të radios Blue Sky (çdo ditë në ora 14:00).

Ediconet për të shurdhërit: Në Janar të 2005-tës me përkrahjen e OSBE-së kemi nisur edhe me edicionin special informativ për të shurdhërit në shqip dhe në serbisht.

Yekhipe: Nga Janari i viti të kaluar, magazinë javore në gjuhën rome “Yekhipe” është shtrirë në kohëzgjatje 30 minutëshe nga të 20 minutat sa zgjaste në fillim (gjatë 2004-tës). Synimi jonë kryesorë për të ardhmën është që të fillojmë edhe një edicion të rregullt ditor informativ në gjuhën rome.

Projektet për fëmijë: Dy projekte të rëndësishme për fëmijë në gjuhën serbe “Rruga sesam” dhe “Magazina e fëmijëve të Ballkanit janë transmetuar përgjatë vitit 2005 si strategji për afrimin e fëmijëve të komuniteteve të ndryshme, për t’i bërë ata të vetdijshëm për prezencën e njëri tjetrit dhe për t’ua krijuar ndjenjën e bashkëjetesës.

Kori multietnik i Fëmijëve “Zogjtë këndojnë”: Në fillim të vitit 2005 RTK-ja ka themeluar korin multietnik të fëmijëve, të parin e llojit në Kosovë, i cili merr pjesë në prodhimin e emisioneve muzikore për fëmijë me program në të gjitha gjuhët e komuniteteve dhe i cili dirigjohet nga në dirigjent shqiptar dhe një serb. Kori përbëhet nga nxënësit shqiptarë dhe serbë të rajonit të Gjilanit.

Një prezantim mbresëlënës i këtij kori ishte edhe paraqitja në Gala Koncertin e organizuar nga ana e RTK-së për Përvjetorin e Paqës në Kosovë më 12/06/05, si dhe në koncertin tashmë tradicional të kërshëndellave I cili organizohet së bashku me Zyrën amerikane në Prishtinë..

Videoletters: Poashtu në Prill të 2005-tës krahas projekteve të veta multietnike (Dialogu për të ardhmën, Nëpër Kosovë), RTK-ja ka filluar edhe me transmetimin e një projekti të shkëlqyeshëm holandez, “Videoletters”, i cili fokusohet në luftën dhe pasojat e saj përgjatë tërë territorit të ish-Jugosllavisë. Dëshmitarët protagonistë të ciklit të dokumentarëve nga vise të ndryshme të ish-Jugosllavisë flasin në gjuhën e vet për përjetimet e tyre dhe kjo është ruajtur edhe gjatë transmetimit me anë të përkthimit të titruar.

Magazinat javore dhe edicionet e rregullta të lajmeve ditore në gjuhët e komuniteteve,

lirisht mund të themi se kanë shënuar ngritje të cilësisë dhe kanë pasuruar programin e përgjithshëm të Televizionit të Kosovës.

Në fund mjaft debate dhe intervista të transmetuara fillimisht në origjinal janë titruar apo mbisinkronizuar dhe më pas janë transmetuar edhe në gjuhën shqipe.

Intervistat dhe debatet më të rëndësishme janë plasuar në video-format edhe në Ueb Faqen e RTK-së.


Për herë të parë, RTK-ja ka realizuar intervistën vjetore me Kryetaren e Bordit të RTK-së në fund të vitit 2005, në interaksion me publikun, i cili ka qenë i ftuar për pjesëmarrje aktive përmes pyetjeve të shumta të postuara në internet.

Gjatë vitit 2005 edhe nëpër segmente të tjera programore janë bërë hapa të rëndësishëm për interaksion me publikun përmes e-mailave dhe sms-ave nga shikuesit, të cilët janë inkorporuar rregullisht në përmbajtjet e emisioneve.


Struktura gjuhësore në Programet e Televizionit të Kosovës

Paraqitja grafike e raportit në mes të programit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhët e komuniteteve, shprehur në përqindje:

1. Programi në gjuhën shqipe: 83.63%
2. Programi në gjuhët e komuniteteve: 16.37%



1. Lajmet në gjuhën shqipe: 79.3%
2. Lajmet në gjuhët e komuniteteve: 20.7%



Programi kulturor, artistik, dokumentar, arsimor dhe për fëmijë (PKADF)

Edhe gjatë vitit 2005 ky program i ka realizuar në tërësi përcaktimet programore, në pikëpamje të vëllimit madje edhe është tejkaluar planifikimi.

Përmbajtjet programore kulturore dhe artistike qenë në shërbim të vlerësimit dhe afirmimit të vlerave kulturore artistike dhe letrare në Kosovë. Janë realizuar emisione të suksesshme “Pro arte” me krijues tanë të afirmuar, pastaj debate referencash të rëndësishme në emisionin “Dialog plus”, etj.

Kemi vazhduar ta konsolidojmë dhe të avansojmë një Program ARSIMOR, me depërtime të suksesshme veçanërisht me emisionet “Letërsia”, “Artet”, “Ne dhe mjedisi”, etj. Kanë vazhduar përgatitjet për emisionin e ri arsimor “Edukata muzikore”, me të cilin do të startojmë në ciklin veror 2006.

Programi për fëmijë i Televizionit të Kosovës ishte mjaft i pasur dhe atë me një strukturë që përfshin të gjitha grup-moshat e fëmijëve. Vlen të veçohet kuizi “1,2,3, fillo” që u prit shumë mirë nga shikuesit tanë, si dhe risia e këtij viti, emisioni “Shkolla ime” që prezenton veprimtaritë mësimore e jashtëmësimore të shkollave tona.

Gjatë vitit 2005 u është dhënë hapësirë më e madhe edhe krijuesve të jashtëm në zhanrin e programit dokumentar dhe njëherit janë plasuar edhe video-produksione të pavarura. Ky guxim nga ana e RTK-së përpos që ka rezultuar me freskimin dhe pasurimin e skemës programore poashtu edhe ka inkurajuar dhe afirmuar të gjithë të talentuarit, të cilët kanë cilësi për t’u ofruar shikuesve dhe të cilët edhe e gjejnë vehten në angazhimet për mediumin tonë.

Programi argëtues muzikor (PAM)

Në kuadër të PAM-it edhe këtë vit është ndjekur tradita e transmetimit të drejtpërdrejtë të disa prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore dhe argëtuese botërore ku përfshihen: Koncerti i Vitit të Ri i Filharmonisë së Vienës, San Remo, Eurosong, pastaj ceremonitë për ndarjen e çmimeve për muzikë (Grammy, Britt Aëards, Emmy Aëards) dhe për film (Golden Globe, Oscar, BAFTA).

Krahas pasurimit me materialet e huazuara të sipërpërmendura, të cilat përzgjidhen me kujdes në funksion të informimit të audiencës me vlera të vërteta në skenën kulturore e artistike PAM-i ka lansuar dy emisione të reja dhe një cikël dy pjesësh të dokumentarëve ekskluziv nga Japonia, prodhim i TVK-së. Filmat dhe serialet si dhe emisionet e rregullta muzikore e argëtuese të prodhuara nga Televizioni i Kosovës përmbyllin rrëfimin e një pune të suksesshme në këtë departament.

Emisionet e reja

Teen: Kompleton departamentin e të rinjëve në kuadër të PAM-it duke qenë një hapësirë ku përfshihen vetëm interesimet e grup-moshave prej 13-18 vjeçare dhe për të qenë më i afërt me ta, ai edhe moderohet nga dy tinxhere. Përndryshe, emisionet tona tjera u dedikohen të rinjëve 18 vjeçarë e tutje.

Ladies Night: Si një emision sezonal-veror, u lansua për herë të parë këtë vit dhe ndryshe nga Koktej Vere me të cilin ka ngjashmëri në strukturë, i kushtohet vetëm femrave dhe moderohet nga femrat.

Cikli i emisioneve nga Japonia: Me ftesë të MOFA-së (Ministritë së Punëve të Jashtme të Japonisë), një ekip i RTK-së ishte mysafir nderi në Japoni për 14 ditë, me ç'rast iu dha rasti për të xhiruar 12 dokumentare cilësore ekskluzive për RTK-në, në të cilat shtjellohen: civilizimi, tradita e kultura e lashtë japoneze, ekonomia, aspekte të ndihmës së Japonisë për Kosovën, tragjedia e Hiroshimës, aktiviteti i artistëve të atjeshëm dhe synimet e tyre për afrim me artistët tanë.

Tempoja e realizimit të përafërsisht një dokumentari në ditë është arritur me planifikim të mirë paraprak nga ekipi dhe aranzhimin e intervistave me personalitetet relevante përfshirë edhe një të mbijetuar të bombës atomike, me ndihmën e Zyrës Ndërlidhëse të Japonisë në Prishtinë, që para nisjes. Cikli i parë prej 6 dokumentarësh është transmetuar në periudhën qershor-shtator 2005 kurse cikli I dytë për shkak të mbingarkesës së kapaciteteve të postproduksionit është planifikuar për vitin 2006.

Serialet vendore: Dy serialet vendore “Familja Moderne” dhe “Kafeneja Jonë”, edhe në vitin 2005 kanë pasur një shkallë jashtëzakonisht të lartë të popullaritetit, dhe si rezultat mbeten ndër programet më të shikuara në Kosovë.

Ndonëse, orientim kryesor yni ka qenë programi informativ, konsiderojmë se me investimin në këto dy seri kemi arritur të ruajmë baraspeshën e domosdoshme programore duke u ofruar shikuesve tanë edhe diç më tepër nga produksioni ynë.

Sa I përket serialeve dhe programeve të tjera të huazuara, RTK-ja edhe gjatë vitit 2005 me këmbëngulësi I mbeti besnik orientimit për mosblerjen dhe mosmetimin e serialeve dhe programeve me vlera të dyshimta.

Koncertet dhe evenimentet: Projekt i ri ambicioz i RTK-së këtë vit ishte organizimi i Gala Koncerit të RTK-së me rastin e përvjetorit të paqes në Kosovë më 12 Qershor. U ftuan për pjesëmarrje vetëm ata nga solistët e gatshëm për interpretim LIVE, me përcjelljen instrumentale të Big Band-it të RTK-së. Mysafirët e ftuar ishin përfaqësuesit më eminentë të institucioneve vendore e ndërkombëtare në Kosovë dhe ata të zyrave diplomatike në Prishtinë. Një simbolikë e posaçme ishte paraqitja e Korrit Multietnik të Fëmijëve si uvertyrë para shpalosjes së programit të koncertit.

Projekti tashmë tradicional dhe i përbashkët i RTK-së dhe Zyrës Amerikane, koncerti me rastin e 4 Korrikut “Tung Amerikë”, u mbajt edhe këtë vit dhe u bë i vecantë me pjesëmarrjen e ish Sekretares Amerikane të shtetit Znj. Madeline Albright.

Ngjarje të tjera të cilat kulturore të cilat realizohen në bashkëpunim me ne apo që transmetohen rregullisht prej nesh janë: 3 Mbrëmjet e “Kamerfest-it 2005”(muzikë klasike), Koncertet e Filharmonisë së Kosovës, Koncerti i Akademisë së Muzikës (35 vjetori) dhe Jazz Festivali i Prishtinës i cili nisi për herë të parë këtë vit dhe synohet të jetë tradicional.

RTK-ja ka qenë sponsor medial I shumë ngjarjeve të rëndësishme kulturore në Kosovë.

RTK Big Band: Kjo trupë prej 24 instrumentistësh profesionalë, u themelua me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe begatimit të emiseoneve të RTK-së, si dhe me qëllim të krijimit të një infrastructure të domosdoshme muzikore në mënyrë që të hyhet në realizimin e projekteve shumë të ndërlikuara dhe të rëndësishme muzikore e kulturore. Në këtë kontekst do përmeëndur realizimi i shkëlqyeshëm i Gala Koncertit të RTK-së, në qershor, me interpretim ‘Live’ të Big Bendit si dhe këngëtarëve, I cili më shumë se një emision televiziv ishte një ngjarje e rëndësishme kulturore.

Në të ardhmen, një prej objektivave kryesore të RTK Big Bendit do të jetë realizimi i Festivalit të rregullt muzikor të RTK-së, i cili me vendimin e RTK-së, do të filloj që nga Nëntori i vitit 2006 dhe do të jetë i përvjetshëm.

Është paraparë që atëherë kur të përmbushen kushtet formale statutore për anëtarësim të plotë të RTK-së në EBU, kënga fituese e këtij festivali do ta përfaqësoj Kosovën në Këngën e Eurovizionit.

Programi Sportiv

Programi i sportit ka realizuar vëllim të madh të programit, duke u kujdesur që shikuesve t’i sjellë programin më interesant dhe më cilësor të sportit vendor dhe atij ndërkombëtar.

Ngjarjet ndërkombëtare kanë qenë kampionati i futbollit anglez, Liga e kampionëve, Euroliga e basketbollit (deri në prill 2005) dhe NBA(deri në qershor 2005).

Përveç transmetimeve nga keto ngjarje ndërkombëtare, janë përgatitur edhe emisionet speciale (Pasqyra e ligës angleze, magazina e Ligës së kampionëve, NBA Action dhe Liga spanjolle).

Risi e Programit të sportit ka qenë edhe emisioni sportiv argëtues, i cili i ka paraprirë ndeshjeve të ligës së kampionëve.

Krahas programit të pasur sportiv me transmetime të drejtëpërdrejta, programi i sportit është përkujdesur që në programin e vet të ketë edhe ngjarje sportive nga vendi.

Programi i sportit të TVK-së ka përcjellur në mënyrë të veçantë edhe ndeshjet e kombëtares së Shqipërisë, duke i paraprirë kësaj ngjarje me emision special në studio, me mysafirë të ftuar dhe audiencë.

Programi i sportit në emisionet e veta informative ka sjellur risi me SPORT PLUS, që është mirëpritur nga audiencia e TVK.

I rëndësishë së veçantë është vendimi i miratuar që nga viti i ardhshëm të fillojë realizimi i një projekti shumë amicizoz programor për zgjedhjen e sportitëve të vitit të në Kosovë nga ana e RTK-së.

Në vazhdim po ju paraqesim ngjarjet e sportit të cilat TVK i ka mbuluar gjatë periudhës janar-dhjetor 2005.

Sporti vendor:

- Atletikë - Gjysmëmaratona ndërkombetare “Prishtina 2005”
- Futboll -Finalja e kupës së Kosovës.
- Basketbolli vendor - (Ndeshjet kampionale dhe të kupës)
- Hendboll (Ndeshjet nderkombetare, finalja e kupës së Kosovës)
- Volejboll (Ndeshjet kampionale dhe finalet e kupës së Kosovës)
- Tenis - turneu vendor (Dielli OPEN dhe turneu perkujtimor “Faton Islami”)
- Boks vendor (Turneu i boksit “Adem Jashari”, meçe ndërkombëtare të boksierëve kosovarë)
- Streetball 2005 (finalet e basketbollit ne rruge)
- Volley beach (finalet e volejbollit ne rere)

Sporti ndërkombëtar:

- Boks-Luan Krasniqi.
- Futboll-Ndeshjet e kombëtares së Shqipërisë.
- Futboll- Liga e Kampionëve
- NBA-Basketbolli amerikan.(qershor 2005)
- Euroliga-Basketbolli evropian(prill 2005)
- Futboll-Premierliga angleze - ndeshjet kampionale.

Programi i mëngjesit (PM)

Gjatë një viti emisioni i mëngjesit “Mirëmëngjesi Kosovë”, (P.M.) ka arritur të ketë një dinamikë të kënaqshme duke u ofruar shikuesve një program të pasur dhe të larmishëm. Trajtimi i temave aktuale, shpesh ekskluzive, informimi i shpejtë dhe i saktë, kronikat nga terreni, e kanë karakterizuar programin e mëngjesit gjatë vitit 2005. Futja e ideve të reja në emision, kryesisht që kanë të bëjnë me realizimin e kronikave të veçanta që pëlqehen nga audienca ka ndikuar në ngritjen e cilësisë programore. Në mënyrë te veçantë, nga ora 8.00 deri në 9.30 kur edhe përfundon P.M. programi ka qenë mjaft i ngjeshur me tema të llojllojshme nga politika, ekonomia, çështjet sociale, sporti, kultura etj. P.M. ka arritur në këto kushte dhe mundësi që ka RTK-ja, të ruajë reputacionin në audiencë. Megjithëse nuk ka sondazhe të rregullta për këtë pjesë të programit të RTK-së, informacionet që marrim tregojnë se P.M. renditet në mesin e emisioneve më të ndjekura dhe me ndikim në opinion.

Operacionet Teknike-Televizion

Gjatë vitit 2005 janë realizuar 923 transmetime të drejtpërdrejta, nga të gjitha pikat e mundshme në Kosovë, duke përdor 2 linka tokësor mobil dhe pjesen e lidhjes mikrovalore fikse Golesh – Prishtine. Janë mbuluar ngjarjet e ndryshme informative, kulturore dhe sportive në Kosovë dhe jashta Kosoves; transmetime nga Kuvendi

Kosoves, ngjarjet kulturore, argetuese, sportive transmetime të liges së basketbollit, futbollit, hendbollit, etj,

Për nevoja të departamentit Informativ janë bërë koordinime programore dhe teknike për transmetime dhe xhirime multilaterale dhe unilaterale: Seanca e Këshillit të Sigurimit, Parlamentit dhe Komisionit evropian, Tribunalit të Hagës etj, si dhe transmetime unilaterale të gazetarëve tanë.

Për programin argëtues dhe sportiv jane bërë koordinimet teknike për ngjarjet më të medha gjatë vitit 2005. Për programin muzikor në koordinim me departamentin e programeve të huaja është bërë transmetimi i Koncertit te Vitit te Ri, ndarjes së çmimit Oscar, EMMY aëards, Eurosong si dhe të shumë ngjarjeve tjera .

Gjatë kësaj periudhe janë transmetuar drejtpërdrejt mbi 21 ndeshje futbollit në kuadër të kualifikimeve për “Gjermania 2006”, mbi 130 ndeshje të Ligës Angleze në Futboll, 20 ndeshje të kupës së UEFA-së dhe 24 ndeshje të Ligës së Kampioneve. Poashtu kemi transmetuar meçe të boksit, përmbledhje të shumta nga kampionati anglez dhe spanjoll. Gjatë këtij viti në koordinim me EBU-në si dhe Radio Televizionet Botërore dhe ato Europiane janë kryer 189 transmetime multi dhe unilaterale për nevoja të këmbimit të lajmeve në rrjetin e EBU-së, si dhe unilaterale me kërkesë nga anëtarët e EBU-së, RTV tjera botërore për transmetime, si dhe për shfrytëzimin e mundësive tekniko teknologjike të RTK-se, montazhë ENG kamera, studio si dhe stand-up pozicione.

Edhe në vitin 2005 u dëshmuua profesionalizmi i stafit të RTK-s, kur për të dytën herë me radhë, në Tiranë, transmetoi drejtpërdrejt ndeshjen futbollistike “Shqipëri – Danimarkë” të vlefshme për kualifikime në kampionatin Botëror Gjermania 2006, për audiencën bë Shqipëri, KOsovë dhe diasporë si dhe anëtarët e interesuar të EBU-së.

Në vijim pasqyra tabelare e transmetimeve që janë bërë brenda dhe jashtë Kosoves:

TRANSMETIME DIREKTE DHE REKORDIME NGA JASHTË KOSOVA	821
TRANSMETIME DIREKTE DHE REKORDIME MBRENDIA KOSOVE	102
FEED TË DËRGUAR NGA RTK	189

Përkundër vështërsive buxhetore, sektori i Operacioneve Teknike, në vitin që e lam pas, është përpjekur që vizuelisht të jetë në hap me qendrat tjera televizive evropiane. Ndër projektet prioritare dhe më serioze veçojmë reformën vizuele dhe përmbajtsore të Lajmeve qendrore, reformat vizuele të të gjitha edicioneve tjera të Lajmeve, shtimin e dy edicioneve (5 minuta) të Lajmeve në orën 15:00 dhe 00:00, lajmet për shurdhëmec si dhe kronikën e lajmeve rajonale “ NË – PËR KOSOVË “. Për këto reforma është angazhuar një numër i konsiderueshëm i stafit të RTK-s, dhe si rezultat kemi arritur që të krijojmë një identitet *Audio-Vizuel të Televizionit të Kosovës*.

Vlen te ceket *Gala koncerti i RTK-së* i mbajtur në qershor 2005, ku puna e gjithë stafit realizues, nga shume kritik dhe artdashës është vlersuar si mjaft e suksesshme, sidomos kur të kihet parasysh se I tërë koncerti është realizuar LIVE.

Në vijim e keni pasqyrën tabelare të shërbimeve të ofruar nga sektori i Operacioneve Teknike :

NJËSITI I TITRAVE :

FILMA	90'	51	75.00
SERIALE	40'	61	41.06
DOKUMENTAR	45'	26	19.50
PROGRAME ARSIMORE	25'	20	08.30
KATALOG	50'	13	12.20
DOKUMENTAR SPORTIV (GILLETTE)	25'	27	11.25
FILMI ANIMUAR	90'	1	1.30
MUZIKË	90'	2	3.00
SERIALE	50'	116	97.00
INTERVISTA	50'	6	05.00
NË-PËR KOSOVË	3'	21	1.03
TOTALI			275.40

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky

Përmbledhje

RTK-Radio përbëhet nga dy radiostacione: Radio Kosova and Radio Blue Sky.

Radio Kosova ka filluar programin e vet në fillim të gushtit 1999, me përkrahjen e OSBE-së, kurse Radio Blue Sky u themelua me mbështetjen e OKB-së dhe të Zvicrës në fund të gushtit 2000 dhe pastaj u integrua brenda RTK-së.

Që të dy këto radio kanë program 24-orësh, prej të cilave 19 orë me moderatorë në studio dhe me pjesën tjetër me programe muzikore pa moderatorë.

RTK-Radiot janë multietnike, me programe në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

Që të dy radiot janë ndërtuar mbi parimet e transmetuesit publik duke i ofruar auditorit të tyre lajme korrekte dhe të balancuara, emisione edukative, sportive dhe argëtuese.

Radio Kosova është “radio për të gjithë” i formatit të radios nacionale dhe i drejtohet kryesisht një auditori mbi moshën 25-vjeçare, kurse Radio Blue Sky i drejtohet një auditori nën moshën 25-vjeçare.

Radio Kosova transmeton programin e vet në rrjetin terrestrial FM, përmes transmetuesve 10 KË me valë të mesme, përmes striming-ut live në internet dhe në satelit si audio-kanal i dytë i RTK-së.

Radio Blue Sky transmeton programin e vet në rrjetin FM, striming-ut live në internet dhe në satelit si audio-kanal i tretë i RTK-së.

Sipas sondazheve të ndryshme që janë bërë pas vitit 1999 e deri më tani, Radio Kosova është radioja më e besueshme në vend, kurse Radio Blue Sky është radiostacioni më i dëgjuar për të rinjtë në Kosovë.

Radio Kosova

Programi informativ

Sipas planifikimit programor të Radio Kosovës për vitin 2005, janë realizuar pothuajse të gjitha parashikimet programore. Nga edicionet e lajmeve janë mbuluar të gjitha ngjarjet politike në vend dhe në botë, kurse në programet e aktualiteteve të tipit analitik janë debatuar, shqyrtuar dhe analizuar në studio dhjetëra ngjarje.

Gjatë vitit, është startuar një edicion i ri lajmesh prej 11 minutash: Lajmet e orës 08.00, tani edicion i zgjeruar. Një edicion i tillë informativ i ka munguar Radio Kosovës dhe me futjen e tij në skemën programore, është mbuluar një zbraçeti informative për dëgjuesit në orët e hershme të mëngjesit. Edicioni aktual, është i përditësuar, me pjesë tonike, me lajmet më të reja dhe me ngjarjen bazë të edicionit.

Në ndërkohë, janë forcuar edicionet ekzistuese të lajmeve me përmbajtje të reja dhe me përf forcime editoriale.

Programet e tjera

Është startuar i plotë programi arsimor dhe shkollor, me plotësime tematike, me rubrika si: “Nga meridianët”, “Juristi ju përgjigjet”, “Këshilla mjekësore”, “Nga historia e artit”, etj. Në programin e natës (çdo të shtunë) ka filluar një emision mjaft i dëgjuar për mendimin pozitiv me tema të ndryshme nga përditshmëria jonë. Është zgjeruar, nga 30 minuta në një orë, emisioni i së dielës për fëmijë, “Kolovajza e së dielës”, kurse në mungesë të emisioneve humoristike në Radio Kosovë ka filluar transmetimi i emisionit me humor:”Hem për burra, hem për gra, shumë i mirëpritur nga dëgjuesit.

Gjatë sezonit veror, Radio Kosova organizoi programet javore të drejtpërdrejta “Kopshti veror i Radio Kosovës”, emetuar nga kopshti para ndërtesës së Radios, me publik dhe me pjesëmarrjen e ansambleve të muzikës popullore dhe argëtuese. Pesë emisione të tilla, në kuadër të këtij projekti, janë pritur shumë mirë nga dëgjuesit.

Me AUTO-REPORTAZH janë transmetuar manifestime të ndryshme midis të cilave manifestimin tradicional të faljeve të Bajramit; Manifestimin e Krishtlindjes nga Kisha katolike në Prishtinë, emisione të mëngjesit, etj. Janë realizuar disa rubrika të reja në kuadër të programit të mëngjesit. Do veçuar rubrikën:”Me kafën e mëngjesit”, që është transmetuar çdo të premte. Në kuadër të kësaj rubrike nga fundi i vitit 2005, ka pasur intervista me personalitete të shquara në Kosovë, Shqipëri, e më gjerë, përfshirë shumë intervista me intelektualë, regjisorë, piktorë, artistë, shkrimtarë, etj.

Besueshmëria



Kosova = 19.5%
 Dukagjini = 16.7%
 Radio 21 = 7.6%

Burimi: Index Kosova

Dëgjueshmëria



Dukagjini = 45.4%
 Kosova = 33.9%
 Radio 21 = 14.4%

Programi në gjuhët e komuniteteve në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky

Programi në gjuhën serbe: Gjatë vitit 2005 ka vazhduar programi ditor dyorësh në gjuhën serbe në Radion Blue Sky – duke filluar nga ora 14:00 dhe deri në orën 16:00. Ka vazhduar gjithashtu edhe transmetimi i radio lajmeve prej 5 minutash në gjuhën serbe në Televizionin e Kosovës. Janë përcjellë në mënyrë profesionale të gjitha ngjarjet kryesore në vend, rajon dhe botë. Po ashtu programi është pasuruar me raportet e korrespondentëve nga pjesa veriore Mitrovicës, nga Graçanica dhe nga rajoni i Gjilanit. Programi në gjuhën serbe është avancuar në përmbajtje dhe cilësi.

Programi në gjuhën turke: Programi në gjuhën turke ka vazhduar të jetë atraktiv dhe cilësor, shumë i afërt për komunitetin turk në Kosovë. Programi në gjuhën turke ka informuar komunitetin turk në Kosovë në bazë ditore lidhur me ngjarjet në Kosovë dhe

sidomos nga jeta e komunitetit, si dhe ka pasur pjesë muzikore dhe kulturore. Redaksia ka mbajtur një kontakt të ngushtë me dëgjuesit dhe bashkëpunim konkret me KFOR-in turk që gjendet në Prizren. Programi turk është transmetuar në terminin prej 16:00 – 18:00, për t’iu përshtatur kërkesave të dëgjuesve të këtij programi.

Programi në gjuhën boshnjake: Gjatë vitit 2005, programi në gjuhën boshnjake, që transmetohej çdo ditë nga ora 12:30 deri në 14:00 është zgjeruar për gjysmë ore dhe tani transmetohet prej orës 12:00. Në program janë shfrytëzuar tre korrespondentë nga mese të ndryshme ku jeton komuniteti boshnjak në Kosovë. Programi në gjuhën boshnjake është përqendruar në informimin ditor nga Kosova, bota dhe sidomos nga komuniteti boshnjak në Kosovë duke përfshirë edhe segmentin kulturor dhe argëtues-muzikor.

Radio Blue Sky

Programi informativ

Gjatë vitit 2005, Radio Blue Sky ka vazhduar të transmetojë gjatë ditës 13 edicione lajmesh. Ato janë transmetuar në çdo gjysmë të orës së plotë, me një edicion informativ pesëminutësh në orën 13.00, i cili është transmetuar çdo ditë edhe nga Televizioni i Kosovës. Edicionet e lajmeve janë përgatitur në bashkëpunim të ndërsjellë midis dhomave të lajmeve të të dy radiove. Në aspektin cilësor është shënuar rritje me një angazhim më të madh të stafit të gazetarëve dhe të redaktorëve dhe me shfrytëzimin maksimal të korrespondentëve të të dy radiove.

Dokumentarët dhe gazetaria hulumtuese nuk ka munguar as këtë vit në Radio Blue Sky. Këtë e dëshmon edhe çmimi special dhe ai i publikut për gazetaren tonë në konkursin e Organizatës jo-Qeveritare “Hope for the Future” dhe Radio Deutche Ëelle për Evropën Juglindore me dokumentarin “Dhuna në Familje” .

Programet e tjera

Si radio që u dedikohet dëgjuesve nën moshën 25-vjeçare, Radio Blue Sky ka ofruar program të pasur dhe të larmishëm muzikor nga zhanre të ndryshme të muzikës më të re në botë dhe tek ne. Janë prezantuar vlerat muzikore përmes emisioneve speciale muzikore, të top listave e të emisioneve të kontaktit. Është ndjekur hapi me produktionet e fundit muzikore dhe kulturore. Në shkurt 2005 është transmetuar drejtpërdrejt manifestimi i ndarjes së çmimeve të MTV-së për Britani “BRITISH AËARDS”. Disa nga segmentet më atraktive programore në Blue Sky kanë qenë: Metropol, EUROSONG, Fokus letrar, ZËRI I ARSYES (emision për personat me aftësi të kufizuara), etj.

Operacionet Teknike-Radio

Sektori i teknikës gjatë vitit 2005 realizoi objektivat kryesore të përcaktuara me planin e biznesit për vitin 2005. Gjatë vitit 2005 teknika e RTK-Radio iu përgjigj me sukses kërkesave programore duke realizuar një numër të madh transmetimesh nga ngjarje të ndryshme kulturore, politike, sportive, fetare, etj. Është realizuar në tërësi edhe kontrata me SDC-në, projekt i Qeverisë Zvicerane për RTK-Radio.

Gjatë vitit 2005, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë realizuar rreth 150 transmetime të drejtpërdrejta. Transmetimet kryesore kanë qenë: Koncerti tradicional i Filarmonisë së Vjenës (1 janar 2005); Transmetimit i British Aëards (shkurt 2005); transmetimi i manifestimit të 12 qershorit nga stadiumi i Prishtinës; Festat e Bajramit dhe Kërshëndellat, etj. Është testuar ISDN lidhja dhe është bërë transmetimi me ISDN lidhje nga Shqipëria i ndeshjes Shqipëri-Ukrainë me sukses dhe kualitet të lartë tonik. Përveç këtyre transmetimeve, janë realizuar edhe emisione të drejtpërdrejta me autoreportazh, si në emisionin Metropol të Radios Blue Sky gjithashtu manifestimi për 4 Korrik para Teatrit kombëtarë në Prishtinë kur transmetimi është bërë nga autoreportazhi. Transmetimi i Kërshëndellave me 24 dhjetor 2005 është bërë me autoreportazh dhe për herë të parë është testuar AUDIO TX STL-IP pajisjet, donacion i SDC-se, për transmetim përmes internetit. Toni internacional i prodhuar nga teknikat e radios në këto manifestime u është dhënë në shfrytëzim TVK-së dhe televizioneve të tjera. Përveç këtyre transmetimeve, është realizuar një numër i madh transmetimesh përmes internetit nga Gjykata e Hagës.

Gjatë vitit 2005 është bërë edhe blerja dhe instalimi i domen-serverit i cili e ka zëvendësuar domen-serverin e vjetër në ruajtjen e shënimeve të shkruara të gazetareve.

Web Faqja e RTK-së

Ueb-faqja e RTK-së (www.rtklive.com) ka një shtim të konsiderueshëm të numrit të vizitorëve. Ka, po ashtu, edhe një shtim në cilësinë e shërbimeve dhe shpeshtësisë së plotësimit, stabilitetit dhe funksionalitetit të ueb-faqes.


Aktualisht, roli i ueb-faqes së RTK-së është i shumëfishtë. Ai nuk pasqyron vetëm RTK-në në mediane të internetit, por edhe plotëson rolin e saj si transmetues publik. Pas lajmeve ditore me tekst, i cili përditësohet gjatë tërë ditës, ueb-faqja ka edhe pjesën e video-lajmeve dhe të radio strimingut.

Po ashtu, gjatë vitit 2005, krahas lajmeve në videoformat, kemi filluar edhe me lajme të shkruara në gjuhët e komuniteteve etnike që jetojnë në Kosovë, Një pjesë e rëndësishme e ueb-faqes i kushtohet RTK-së. Pas informacionit të përgjithshëm mbi transmetuesin publik, frekuencat, historisë së shkurtër, stafit dhe auditorit, aty botohen edhe dokumentet zyrtare të RTK-së. Kjo faqe është pasqyrim i transparencës, në të cilën vizituesit kanë qasje në publikimet e RTK-së, si raportet vjetore, deklaratat e veçanta lidhur me ngjarje të ndryshme, raportet e auditimit, si dhe

botime të ndryshme, si tenderët, shpalljet, konkurset etj. I tërë materiali jepet në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Nga 10.000 vizitues në ditë, sa ishte numri një vit më parë, gjatë vitit 2005 numri mesatar i vizituesve është ngritur në 14.000.

Në bazë vjetore, numri i tërësishëm i vizituesve arrin në 3.849.671 apo afro 321.000 vizitues në muaj. Grafikat në vazhdim paraqesin ngritjen e vazhdueshme të qasjes në ueb-sajtin e RTK-së.



Paraqitja grafike e vizitorëve në baza mujore

Administrata

Reforma e përgjithshme në RTK. - Me iniciativën e RTK-së, OSBE-ja ka financuar një pjesë të projektit lidhur me reformën dhe kompletimin e infrastrukturës së brendshme juridike në Radiotelevizionin e Kosovës. Nisur nga kjo, OSBE-ja ka angazhuar ekspertët nga Sllovenia me qëllim të zbatimit të përvojave dhe njohurive të tyre në RTK, në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, në fushën e rregullimit të brendshëm të transmetuesve publikë. Duke filluar nga 20 tetori 2005, ekspertët nga RTV Sllovenia, nën mbikçyrjen e sektorit të administratës të RTK-së dhe në bashkëpunim me ekipin punues të përbërë nga sektorët përkatëse të RTK-së, kanë filluar punën në realizimin e projektit. Qëllimi kryesor i projektit është vendosja e strukturës së brendshme organizative të dy

radiove dhe televizionit të Kosovës, sistematizimi i vendeve të punës, përshkrimi i hollësishëm i vendeve të punës, paraqitja grafike e makro dhe mikro organizimit të RTK-së, metodologjia e vlerësimit të vendeve të punës dhe sistemit të pagave të rregulluara me norma ligjore për të gjithë të punësuarit dhe përpunimi i akteve të brendshme për sistematizimin e vendeve të punës, duke përfshirë katalogun e vendeve të punës me tabelën përkatëse; rregulloren për avancimin e të punësuarve; rregulloren për shpërblimin e të punësuarve dhe aktet tjera normative brenda kompanisë.

Puna complete në realizimin e projektit është bazuar në Rregulloren për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, Kontratën Kolektive në nivel të Kosovës dhe Projektligjin për RTK-në, i cili pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës në fillim të vitit 2006.

Meqë puna lidhur me reformën e përgjithshme në RTK ka filluar në fund të vitit 2005, pritet që puna e gjithmbarshme të përfundojë në etapa gjatë vitit 2006.

-RTK-ja është i pari dhe i vetmi medium në Kosovë me Organizatë të pavarur sindikale. Në mes të Menaxhmentit dhe Sindikatës ekziston një bashkëpunim konkret dhe konstruktiv.

Politika e rekrutimit të kufizuar të stafit të ri në RTK

Në RTK gjatë vitit 2005 është zbatuar politika e propozuar nga menaxhmenti dhe miratuar nga Bordi i Drejtorëve lidhur me rekrutimin e kufizuar të stafit të ri. Fakti se me Planin e Biznesit për vitin 2005 është paraparë që deri në fund të vitit 2005 gjithsej të punësuar në RTK të jenë 442 punëtorë, ndërkaq që në fund të dhjetorit 2005 në RTK janë 428 punëtorë, tregon se zbatohet politika e rekrutimit të kufizuar të stafit të ri në RTK.

Prokurimi

Gjatë vitit 2005, duke ju referuar tabelës së prokurimit në Televizion dhe Radio, ka pasur 1087 kërkesa në televizion dhe 332 në radio. Prej këtyre kërkesave, në televizion dhe radio janë gjithsej 71 kontrata të nënshkruara për shërbime, mallra dhe punë të cilat u janë nënshtruar aktiviteteteve të prokurimit për kontratat me vlerë të vogël, të mesme dhe të mëdha. Procedurave të prokurimit u janë nënshtruar edhe kontratat me vlerë minimale nën 500 € dhe janë përdorur dokumentet standarde të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Zyra e prokurimit ka zbatuar metodat e prokurimit dhe ka përdorur dokumentet standarde e procedurale të ofertimit për mallra, punë dhe shërbime. Vlen të ceket se një numër i vogël i tyre është anuluar dhe disa kanë dështuar, disa kanë mbetur të paaprovuara, e disa janë refuzuar.

Respektimi rigoroz i procedurave të prokurimit është praktikë e punës në RTK.

FINANCAT


Në vitin 2005 RTK ka ndërmarrë një sërë masash në drejtim të zvoglimit dhe kontrollit maksimal të shpenzimeve e që ka rezultuar me me suficit financiar prej 32,926.00€ Gjatë muajit maj dhe qershor 2005, RTK ka përpiluar planin e reduktimeve dhe kursimeve për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2005 e të cilave edhe i është përmbajtur me përpikmëri. Ky plan i reduktimeve dhe kursimeve është paraqitur edhe në Raportin që i është dërguar OSBE-së nga ana e Znj. Bllazhka Tratnik e angazhuar nga ana e OSBE-së në cilësinë e ekspertës financiare. Në Raportin e ekspertës financiare nga Sllovenija shprehen lavdata për planin dhe masat e ndërmara nga ana e RTK-së me qëllim që viti afarist 2005 të mos përmbyllet me deficit. Përkundër vështirësive të mëdha, RTK-ja ia ka dalur që në tërësi të realizojë planet e parashtruara.

Raportet dhe pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2005 janë odituruar nga Kompania ndërkombëtare e oditimit “ Deloitte & Teouche “.

Me sygjërim të kësaj kompanie, në vitin 2005, për herë të parë përlllogaritja e të hyrave nga marketingu është bërë në baza përlllogaritëse (akruale) e jo në bazë të inkasimit të mjeteve (baza kesh).

TË HYRAT

Të hyrat primare të RTK-së në vitin 2005 kanë qenë nga parapagimi e që përbëjnë afro 70% të të hyrave të përgjithshme të RTK-së. Të hyrat nga marketingu kanë gjeneruar 16% të hyrave të përgjithshme. Të hyrat nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës kanë përbërë 8% të hyrave të përgjithshme. Të hyrat nga donatorët kanë përbërë 1% të hyrave të përgjithshme ndërsa të gjitha të hyrat tjera kanë përbërë 5% të hyrave të përgjithshme. Në vazhdim në formë të grafikonit do të paraqesim strukturën e të hyrave të RTK-së gjatë vitit 2005 :



SHPENZIMET


RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe se mjetet e shpenzuara.

Që nga viti 2002 RTK-ja ka themeluar Zyrën e prokurimit me tre punëtorë profesionalë të punësuar pranë kësajë Zyre, të cilët në harmoni me rregulloret në fuqi, i mbikqyrin dhe zbatojnë në mënyrë strikte procedurat e prokurimit.

Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me Rregulloret përkatëse që janë në fuqi. Departamenti i financave i RTK-së veç raportit vjetor, përpilon edhe raportet financiare mujore dhe tremujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe Bordin e Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politikat e shkruara financiare dhe procedurat strikte të kontrollit të shpenzimeve. Asnjë shpenzim nuk mund të lejohet dhe paguhet pa aprovimin paraprak me shkrim të së paku dy personave të autorizuar.

Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, ata me kontrata mbi vepër dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare ashtu sikurse edhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme. Pagesat e mëditjeve për udhëtime zyrtare Brenda dhe jashtë vendit bëhen në bazë të Rregullores së shkruar.

Ne vazhdim ne formë të grafikonit do të paraqesim strukturën e shpenzimeve të RTK-së gjatë vitit 2005 :



Bilancin e Suksesit dhe Bilancin e Gjendjes të RTK-së për vitin 2005 të audituara nga kompania Deloitte & Touche do t'i paraqesim në mënyrë tabelare ;

Bilanci i suksesit të RTK, sipas gjendjes 31 Dhjetor 2005

Nr.	TË HYRAT	EURO	SHPENZIMET	EURO
1	Të hyrat nga parapagimi	5,160,000.00	Programi	2,229,771.82
2	Të hyrat nga marketingu	801,309.70	Pagat	1,972,915.84
3	Të hyrat nga BKK	600,000.00	Amortizimi	1,487,005.00
4	Sponsorimet	356,659.30	Tatimet dhe kontributet	637,629.34
5	Të hyrat tjera	371,791.00	Komunalet	382,783.00
6	Të hyrat nga donatorët	63,300.00	Provizioni nga parapagimi	356,040.00
7			Të tjera	253,989.00
Total të hyrat		7,353,060.00	Total Shpenzimet	7,320,134.00

Bilanci i gjendjes të RTK, me 31 Dhjetor 2005

Nr.	AKTIVI	EURO	PASIVI	EURO
1	Mjetet e gatshme	53,949.00	Kapitali	8,224,083.00
2	Mjetet fikse	4,155,454.00	Obligimet afatshkurtra	681,149.00
3	Materiali dhe inventari	525,530.00	Obligimet afatgjate	9,450.00
4	Kërkesat afatshkurtra	2,928,426.00	Obligimet nga honoraret	71,308.00
5	Deficiti nga vitet paraprake	1,355,557.00	Suficiti në 2005	32,926.00
Totali i aktivitet		9,018,916.00	Totali i Pasivitet	9,018,916.00

